

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“VP - DUTY FREE” Shpk



Sot, më datë 14.10.2019, une i poshtëshënuari:

Z. Petru Voicu, atesia Petre, shtetas Rumun, lindur me 24.03.1958 ne Rumani dhe banues ne Kamez mbajtes i pasaportes me nr. 053300024, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar Me nr.kontakti +355693077831

në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të krijojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**VP - DUTY FREE**” Shpk (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është “**VP - DUTY FREE**” Shpk

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adrese : Lagjia Nr.1, Rruga “Kont Urani”, Vila Kaizer, Apartamenti Nr.5, Durrës.

Neni 3

- 3.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa kufizim.
- 3.2. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4

- 4.1. Objekti i Shoqërisë është: *Ushtrimi i aktivitetit privat ne fushen e biznesit "Duty Free Shops", nepermjete importit dhe tregtimit te mallrave qe tregtohen ne kete rrafsh si parfume, kozmetike, aksesore te ndryshem, pajise elektronike, likerna dhe pije te ndryshme ,cigare, cokollata, lodra per femije etj. Hapje dyqanesh ne territorin e Shqiperise perfshire aeroportet,portet,njesite ne zonat kufitare etj*
- 4.2. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.
- 4.3. Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së kësaj shoqërie, objekt që ajo e vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.
- 4.4. Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti që ka lidhje me objektin e saj.

Neni 5

- 5.1. Kapitali është i përbërë nga 1 (nje) kuota.

Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i shoqërisë është: 1.200.000 (njemilion e dyqindmije) lekë.

8.2. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë zotërohen nga ortaku i vetem Z. Petru Voicu

Ku 1 kuote është e barabarte me 100% e barabarte me vleren 1.200.000 (njemilion e dyqindmije) lekë.

Neni 6

6.1. Derdhja e kuotave të kapitalit themeltar është bërë në mënyrën e sipërpermendur :

6.1. Sipas kontributeve të cituara:

Neni 7

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara nga neni 12 i Statutit.

Neni 8

8.1. Shoqëria administrohet nga administratori. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë, për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

Nëpërmjet këtij akti, emërohen Administrator Z. Petru Voicu Administratori ka të drejtë per ti deleguar personave të tretë, lidhur me të gjitha veprimet qe kerkohen te kryhen nga administratori ne shoqeri .

8.2. Administratori i sipërpërmendur i jepen të gjitha të drejtat e administrimit, të zakonshëm e të jashtëzakonshëm, duke përfshirë edhe nënshkrimin dhe ekzekutimin e të gjitha akteve në emër dhe për llogari të Shoqërisë dhe ai mund të delegojnë pushtetin e tij tek persona të tretë, me prokura të posaçme të noterizuara. Afati i Administratorit emerohet per nje afat prej (5) pese vjet.

Neni 9


9.1. Çdo mosmarrëveshje që lind me Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

9.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Lexuar, nënshkruar



Z. Petru Voicu



STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“VP - DUTY FREE” Shpk

Tiranë më 14.10.2019



Kapitulli I

EMRI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma

Shoqëria **“VP - DUTY FREE” Shpk** është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me ortake:

Z. Petru Voicu , atesia Petre , shtetas Rumun, lindur me 24.03.1958 ne Rumani dhe banues ne Kamez mbajtes i pasaportes me nr. 053300024, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, Me nr.kontakti +355693077831

1.2. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 – Emri

Emri i Shoqërisë është: **“VP - DUTY FREE” Shpk**

Neni 3 – Objekti

3.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është :

Ushtrimi i aktivitetit privat ne fushen e biznesit " VP - DUTY FREE ", nepermjet importit dhe tregtimit te mallrave qe tregtohen ne kete rrafsh si parfume, kozmetike, aksesore te ndryshem, paisje elektronike, likerna dhe pije te ndryshme, cigare, cokollata, lodra per femije etj. Hapje dyqanesh ne territorin e Shqiperise perfshire aeroportet, portet, njesite ne zonat kufitare etj.

Neni 4 – Selia

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresë : Lagjia Nr.1, Rruga “Kont Urani”, Vila Kaizer, Apartamenti Nr.5, Durrës.

4.1. Ortaket mund të vendosi të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 – Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pa kufizuar.

5.2. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të ortakut.

Neni 6 – Përgjegjësitë

6.1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti.

- 6.2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortaku në emrin e tij personal ndaj personave të tretë.



Kapitulli II KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7 – Kapitali

- 7.1. Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i shoqërisë është: 1.200.000 (njemilion e dyqindmije) lekë.

Neni 8 – Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre

- 8.1. Kapitali është i përbërë nga 1 (nje) kuota.
Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i shoqërisë është: 1.200.000 (njemilion e dyqindmije) lekë.
8.2. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë zotërohen nga ortaku i vetem Z. Petru Voicu

Ku 1 kuote eshte e barabarte me 100% e barabarte me vleren 1.200.000 (njemilion e dyqindmije) lekë.

Z. Petru Voicu do te zoteroj 100% te kuotave te kapitalit e barabrate me nje (1) kuote

Neni 9 – Zmadhimi i kapitalit

- 9.1. Ortaku mund të rrisi pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
9.2. Administratori njoftonë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit.
9.3. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 10 - Zmadhimi i kapitalit me aktive të Shoqërisë

- 10.1. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, ortaket mund të vendosin ta zmadhojnë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
10.2. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

Neni 11 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 11.1. Ortaku mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
11.2. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët.

Neni 12 – Transferimi i kuotave të kapitalit

- 12.1. Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen lirisht të tretëve, tërësisht ose pjesërisht.

Neni 13 - Pasojat e kalimit të kuotave

- 13.1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë, për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Kapitulli III ORTAKU I VETËM, ADMINISTRIMI, KONTROLLI

Neni 14 – Të drejtat dhe detyrimet

- 14.1. Ortaku eshte përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë lidhur me çështjet e mëposhtme:
a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
b) ndryshimet e statutit;

- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ ve;
- ç) emërimin, shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15 - Procesverbalet

8.6 Të gjitha vendimet e ortakut regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të shoqërisë.

Neni 16 - Hetimet e posaçme

16.1. Ortaku mund të vendosin nisjen e një hetimi të posaçëm, për parregullsitë përgjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 91 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 17 - Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

17.1. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorit të emruar prej ortakut themeues kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 92 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 18 – Administrimi

18.1. Shoqëria administrohet nga administratori. Ortake emërohet një ose më shumë persona fizikë si Administratorë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje. Në shoqëri “*VP - DUTY FREE*” Shpk emërohet **Administratore Z. Petru Voicu** Administratori ka të drejtë të ju delegojë personave të tretë, lidhur me të gjitha veprimet që kerkohen të kryhen nga administratori në shoqëri.

18.2. **Administratori ka të drejtë e detyrohet të:**

- a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortakët
- b) përfaqësojë Shoqërinë;
- c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- ç) Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakeve për miratim;
- d) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- dh) Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Të raportojë përpara ortakeve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- ë) Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

18.3. Ortaket mund të shkarkojnë administratorin në çdo kohë.

Neni 19 - Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia
19.1. Administratori detyrohet të kryejë detyrat e tije të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratori përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale.

Kapitulli IV

SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 20 - Shpërndarja e fitimeve

20.1. Ortaket kane të drejtë të marrin pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Kapitulli V

PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 21 - Shkaqet e prishjes së shoqërisë

21.1. Shoqëria priset:
a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
ç) nëse nuk kryen veprimtari tregtare për dy vjet;
d) me vendim të gjykatës;

Kapitulli VI

TE NDRYSHME

Neni 22 – Gjuha

22.1. Ky Statut hartohet në 4 kopje në gjuhen shqipe dhe gjuhen italiane.

Neni 23 – Dispozita Perfundimtare

23.1. Ceshtjet qe nuk parashikohen shprehimisht nga ky statut do te rregullohen nga Ligji nr.9901, date 19.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” si dhe ligji nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”.


23.2. Autorizohet ortaku te kryeje te gjitha veprimet prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit per rregjistrimin e ketij Akti Themelimi dhe Statuti dhe pajisjen e shoqerise me NIPT-in perkates ose te emroj nje perfaqesues per regjistrimin e shoqerise.

ORTAKET THEMELUES

Lexuar, nënshkruar




Z. Petru Voicu



I Pranishëm Përkthyesi i Liçensuar : Klodjan Kovaçi

KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0000103300



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Daega vendorer TIRANE
Notere Mimoza R. Shehu
Rruga "Abdyl Frasheri" Pll/3/3
studi_shehu@yahoo.com
Nr. Rep. 6490

Taksa e pulles u pagua

VERE TË TË M NËNSHKRIMI

Vertetetoj se sot me daten 14.10..2019 ne kete zyre Noteriale perpara meje Notere Mimoza R Shehu Notere e Degesa Vendore Tiraneme seli ne adrese Rruga "Abdyl Frasheri" Pll 3.3 u paraqit personalish **Z. Petru Voicu**, atesia Petre, shtetas Rumun, lindur me 24.03.1958 ne Rumani dhe banues ne Kamez mbajtes i pasaportes me nr. 053300024, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar te cilet deklaruan se sa siper eshte Akt-themelimi dhe statut i shoqerise Redaktuare në bazë të nenit 62 germa "ll" te Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë" eshte redaktuar sipas vullnetit te tyre jashte kesaj zyre dhe e nënshkruan atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 102 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

Notere
Mimoza R. Shehu

